



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2018

V E N D I M

Nr. 169 , Datë 31 . 08 . 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.101 Regj., datë 10.07.2018, të z.M. M¹, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër (DRSSH) me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër²”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Subjekti ankues, z.M. M ka parashtruar problematikën e tij, duke sqaruar rrethanat e fakteve si më poshtëcituat:

Me datë 01.09.2007 ka ndërprerë karrierën si Punonjës Policie në Komisarlatin e Policisë Mat, pas 26 vjetësh shërbimi me motivacionin “Për shkurtim të funksionit organik” dhe deri me datë 31.08.2009 është trajtuar me pagë kalimtare. Nga data 01.09.2009 i ka lindur e drejta e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Me datë 27.09.2010 z.M. M ka aplikuar pranë DRSSH Dibër për të përfutur pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas parashikimeve ligjore.

Me vendimin për caktim pensioni nr.530, datë 16.03.2011 DRSSH Dibër ka caktuar për kërkuesin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me masë përfitimi fillestare 12.730 lekë në muaj. Ky përfitim është rishqyrtuar vazhdimisht duke marrë rritjet sipas përcaktimeve të VKM-ve përkatëse.

¹ Me shkresën me nr.1046 prot., datë 24.07.2018 ankuesi ka sjellë dokumentacion shtesë.

² Tek “çdo shkak tjetër” ankuesi i referohet faktit të pronësisë: është njohur si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit A. A. M (i ati) lidhur me tokën bujqësore, regjistruar në Zonën Kadastrale Nr.1908 (Gurrë e Madhe).

Me vendimin nr.530/1, datë 13.12.2011 DRSSH Dibër ka rishqyrtuar pensionin e kërkuesit në zbatim të urdhërimeve të ISSH Tiranë³, duke ndryshuar masën e pensionit nga 13.770 lekë në 14.820 lekë (shumë e cila si rezultat i indeksimit në vite është bërë 16.149 lekë). Më pas, me vendimin nr.330/2, datë 20.01.2017 DRSSH Dibër ka rishqyrtuar përfitimin e kërkuesit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10 142, datë 15.05.2009 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, Të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, në kushtet kur pas verifikimeve përkatëse është provuar se kërkuesi ka tokë në pronësi. Si shkak i rishqyrtimit, z.M. M i ka ndryshuar masa e pensionit nga 16.149 lekë në 12.635 lekë është dhe për pasojë ai ka rezultuar dhe debitor në masën 116.994 lekë. Pas rishqyrtimit të pensionit, për shkak të kësaj debie z.M. M, me vendimin nr.330/3, datë 10.04.2017 të DRSSH Dibër i është bërë ndalesa në kështet mujore të përfitimit në masën 20% të kështit mujor.

Ndërkaq, duke mos qenë dakort me sa më sipër, ankuesi e ka kundërshtuar administrativisht këtë vendim duke iu drejtuar fillimisht Komisionit Rajonal të Ankimimit/DRSSH Dibër dhe më pas Komisionit Qendror të Ankimit /ISSH Tiranë. Sërisht, duke mos qenë dakort me përgjigjet e tyre, këtë pretendim e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor⁴.

Subjekti ankues ka parashtuar para Komisionerit të njëjtat fakte që ka bërë prezent edhe para gjykatës, duke argumentuar si më poshtë lidhur me pretendimin se është diskriminuar nga ana e DRSSH Dibër:

“Vendimi nr.330/3, datë 10.01.2017 është marrë në kundërshtim me kriteret dhe kushtet që parashikon ligji nr.10 142/2009 dhe VKM nr.793, datë 24.09.2010 “Për zbatimin e ligjit nr.10 142, datë 15.05.2009 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, pika b) mbi të cilat llogaritet pensioni i parakohshëm për vjetërsi të ushtarakut.

Ky vendim është marrë në mënyrë të njëanshme pa praninë time si palë, duke dëmtuar interesin tim, pa më thirrur, pa më dëgjuar dhe pa më dhënë mundësinë për tu mbrojtur vetë apo me përfaqësues ligjor.

DRSSH Dibër në marrjen e vendimit nr.330/3, datë 10.01.2017 i është referuar vërtetimeve të lëshuara nga ZVRPP Mat të datave 24.12.2014 dhe 05.12.2016 për regjistrimin e pronës së

³Cituar tek vendimi nr.10, datë 23.02.2018 i Komisionit Rajonal të Ankimimit/DRSSH Dibër.

⁴ Referuar kërkesë-padisë së paraqitur pranë Komisionerit, si dhe fletë-thirrjes së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar z.M, për t'u paraqitur pranë kësaj gjykate me datë 02.08.2018, ora 09:30., si palë në process.

trashëguar nga të ndjerët perindërit e mi, pronë e cila ndodhet në Njësinë Administrative Gurrë, Bashkia Klos; gjë të cilën as ligji nr.10 142/2009 dhe as VKM nr.793/2010, në zbatim të këtij ligji nuk e kërkojnë.

DRSSH Dibër në këtë vendim ka keqinterpretuar bazën ligjore mbi të cilën bëhet llogaritja dhe rillogaritja e pensionit të ushtarakut:

VKM nr.793, datë 24.09.2010 “Për zbatimin e ligjit nr.10 142, datë 15.05.2009 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, Të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, në kapitullin III “Procedurat e përfitimeve dhe dokumentacioni i kërkuar”, në pikën B) të tij ka përcaktuar: “Personat e interesuar duhet të dorëzojnë, së bashku me fletëkërkesën, dokumentacionin e mëposhtëm, për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi:

- *Fotokopje të letërnjoftimit elektronik të nënshkruar nga vetë personi ose certifikatë personale me fotografi.*
- *Certifikatë familjare;*
- *Deklaratë individuale për gjendjen e punësimit;*
- *Vërtetim nga zyrat e tatim-taksave nëse ushtron veprimtari ekonomike si punëdhënës ose i vetëpunësuar;*
- *Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive nëse ka përfituar ose jo tokë, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, vetëm nga personat që janë banorë në fshatra”.*

Subjekti ankues parashtroi se DRSSH Dibër nuk ka marrë parasysh dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësi prove dhe për pasojë as nuk e ka analizuar atë sa i takon pretendimit të tyre se kërkuar ka tokë në pronësi, pasi kjo kërkesë është e vlefshme vetëm për personat që janë banorë në fshatra. Z.M. M ka depozituar në cilësi prove dokumentacionin si më poshtë citohet:

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi nga i ndjeri babai i tij A. M sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave për ndarje e tokës bujqësore për zonat verilindore, duke i plotësuar me tokë sipas ligjit nr.7501/1991 për tokat.
- Formularin nr.6 në emër të të ndjerit A. M.
- Dëshminë e trashëgimisë për kalimin e pronësisë të të ndjerit babait të tij A. M tek trashëgimtari i vetëm i dorës së parë, M. M.
- Vërtetimin e regjistrimit të kësaj pasurie të trashëguar pranë ZVRPP Mat.
- Vërtetim nr.109 prot./2017 të Njësisë Administrative Gurrë, me anë të së cilit vërtetohet se z.M. M nuk është banor i fshatit Gurrë (Njësia Administrative Gurrë) që nga viti 1981

dhe nuk ka përfituar tokë sipas ligjit nr. 7 501/1991 në ndarjen e tokës bujqësore për frymë.

- Vërtetim të Njesisë Administrative Burrel/Bashkia Mat me nr. praktike 4154, datë 26.12.2017 sipas të cilit vërtetohet se z.M. M që nga viti 1981 dhe aktualisht rezulton banor i Njesisë Administrative Burrel, me adresë: “Lgji. “Partizani”, nr.banese 17, Bashkia Mat”.

Lidhur me gjithë sa ka parashtruar, subjekti ankues pretendon se i është nështruar diskriminimit nga ana e DRSSH Dibër, pasi ata e kanë vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të cilin ligji nuk e kërkon, pikërisht për faktin se ai ka tokë në pronësi.

Në përfundim ka kërkuar nga Komisioneri⁵:

- Pavlefshmërinë e Vendimit nr.330/3, datë 10.01.2017 të DRSSH Dibër për rillogaritjen e pensionit për vjetërsi shërbimi të ushtarakut, si një vendim i kundraligjshëm.
- Detyrimin e DRSSH Dibër për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10 142/2009 dhe VKM nr.793/2010 në zbatim të këtij ligji.
- Anullimin e rillogaritjes së pensionit sipas Vendimit nr.330/3, datë 10.01.2017 si një rillogaritje e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të ligjit.
- Kthimin e masës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kushtet e përfitimit të rillogaritjes me datë 12.01.2016 në masën 16.149 lekë; kthimin e diferencës së mbajtur ndërmjet shumës që duhej të merrja me shumën e marrë në fakt 10.421 lekë që nga muaji Janar 2017 e në vazhdim.
- Anullimin e pagesës së debisë së caktuar nga ana e DRSSH Dibër në masën 2.593 lekë në muaj që nga muaji janar 2017 e në vazhdim, në zbatim dhe keq interpretim të ligjit 10 142 /2009 dhe VKM nr.793/2010 në zbatim të këtij ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Subjekti ankues, z.M. M ka paraqitur si shkak të diskriminimit të tij “pronësinë mbi tokën e fituar me trashëgimi nga i ati”, dhe në shpjegim të këtij shkakut ka parashtruar se DRSSH Dibër ka keq interpretuar kërkesën e VKM nr.793, datë 24.09.2010 (“Për zbatimin e ligjit nr.10 142, datë 15.05.2009 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, Të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të kapitullit III “Procedurat e përfitimeve dhe dokumentacioni i kërkuar⁶”), në kushtet kur pas verifikimeve përkatëse është

⁵ Kërkesa që i ka parashtruar edhe përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁶ pikës B) të tij: “Personat e interesuar duhet të dorëzojnë, së bashku me fletëkërkesën, dokumentacionin e mëposhtëm, për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi:.... Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive nëse ka përfituar ose jo

provuar se kërkuesi ka tokë në pronësi, pasi ai nuk është banor në fshat dhe për më tepër pronësinë mbi tokën e kë përfituar me trashëgimi nga i ati dhe jo si rezultat i zbatimit të ligjit nr.7501/1991.

Dokumentimi i pronësisë mbi tokën, sipas Ligjit nr.7501/1999, është një ndër kriteret që ka përcaktuar VKM nr.793, datë 24.09.2010 (dhe që ndikon në përcaktimin e masës së përfitimit të pensionit të parakohshëm). Pavarësisht faktit nëse VKM-ja në lidhje me këtë kriter mund të jetë keq interpretuar nga ana e Komisionit të DRSSH Dibër, parashikimi i këtij kriteri nga VKM-ja (krahas kritereve të tjera) nuk përbën në vetvehte shkakun për trajtim të pafavorshëm të ankuesit.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për paligjshmërinë e Vendimit nr.330/3, datë 10.01.2017 të DRSSH Dibër dhe të pasojave financiare që rrjedhin prej tij, Komisioneri konstaton dhe vlerëson se ky vendim është në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e për rrjedhojë çështja përfshihet në juridiksionin gjyqësor.

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka

tokë, sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" të ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, vetëm nga personat që janë banorë në fshatra”;

informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së z.M. M, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime
Shkaku: “Çdo shkak tjetër”